



**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT**

TË DHËNAT STATISTIKORE 2022

PËRMBAJTJA

HYRJA	3
REZULTATET KRYESORE TË PUNËS SË NJIF-K 2022.....	4
ANALIZA DHE MONITORIMI	5
Të dhënat dhe raportet e proceduara	5
Raportet e Transaksioneve/Aktiviteteve të Dyshimta (RTD/RAD)	5
Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)	9
Raportimi i Deklarimit Kufitar (BCR)	9
Analiza Operative dhe Strategjike.....	11
SHPALOSJA, SHPËRNDARJA DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT	14
Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek autoritetet e zbatimit të ligjit	14
Ndihma hetimore e ofruar për agjencitë e zbatimit të ligjit.....	15
Shkëmbimi i informacionit dhe mbështetja për mbikëqyrësit e pajtueshmërisë	16
NGRIRJA E TRANSAKSIONEVE BANKARE	16
MBIKËQYRJA E BAZUAR NË RREZIK	17
Ndëshkimet Administrative	19
Vetëdijesimi, trajnimi dhe komunikimit për PPP/LFT dhe përforcimi i partneritetit publiko-privat dhe publiko-publik	20
ZBATIMI I SANSKIONEVE NDËRKOMBËTARE.....	22
TIPOLOGJITË E PP/FT	23
BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI VENDOR.....	28
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	29
Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve	29
Memorandumi i Mirëkuptimit.....	32
BUXHETI DHE PROKURIMI	33
Prokurimi Publik	34
Burimet njerëzore & ngritja e kapaciteteve të NJIF-K.....	35
LISTA E SHKURTESAVE.....	36

HYRJA

Rekomandimi 33 i Task Forcës për Veprim Financiar (FATF) kërkon që “*Vendet duhet të mbajë statistika gjithëpërfshirëse për çështje që lidhen me efektivitetin dhe efikasitetin e sistemeve PPP/FT. Kjo duhet të përfshijë statistikat mbi raportet e transaksioneve të dyshimta të marra dhe të shpërndara; për hetimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, ndjekjeve penale dhe dënimeve; mbi pasuritë e bllokuar, sekuestruar dhe konfiskuar si dhe për ndihmë të ndërsjellë juridike ose kërkesave të tjera ndërkombëtare për bashkëpunim*”.

Po ashtu, neni 38 i Ligjit për PPP/LFT kërkon që NJIF-K, BQK, mbikëqyrësit e tjerë sektorial, autoritetet e tjera kompetente që kanë përgjegjësi për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, subjektet raportuese si dhe personat ose subjektet e tjera që kanë detyrime ose funksione sipas këtij ligji, të mbajnë të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse përkatëse për fushën e tyre të përgjegjësisë.

Të dhënat statistikore të mbajtura sipas ligjit në fjalë vihen në dispozicion të NJIF-K brenda afateve kohore të përcaktuara prej NJIF-K, për t'i mundësuar që të rishikojë efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime në përputhje me rrethanat siç kërkohet me ligj. Për këtë qëllim, NJIF-K do të hartojë në vazhdimësi statistika dhe raporte si dhe do të bëjë rekomandime në ato fusha apo sektorë ku shihet se është e nevojshme qoftë në aspektin legjislativ apo në aspektet tjera teknike, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit dhe vetëdijes lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, si në vijim:

- Statistika të përgjithshme rreth raporteve të transaksioneve të dyshimta për PP/FT dhe raporteve të parave në të gatshme;
- Statistika të cilat ndërlidhen me indikatorët e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit;
- Statistika lidhur me numrin e rasteve të hapura nga NJIF-K;
- Statistika lidhur me rastet e analizuar dhe dërguara të institucionet e zbatimit të ligjit nga NJIF-K;
- Statistika lidhur me numrin e kërkesave për informata të pranuar nga institucionet e zbatimit të ligjit;
- Statistika lidhur me numrin e rasteve për të cilat ka pasur shkëmbim informatash me FIU-te tjera ndërkombëtare;
- Statistika lidhur me numrin e personave të hetuar dhe dënuar lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- Statistika lidhur me pasurin e konfiskuar apo sekuestruar lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- Statistika lidhur me numrin e trajnimeve të pranuar apo dhëna nga NJIF-K;
- Statistika lidhur me numrin e inspektimeve të pajtueshmërisë;
- Statistika lidhur me ndëshkimet administrative; dhe
- Statistika tjera të cilat i përkasin dhe janë nën mandatin ligjor të NJIF-K.

Në pajtim me nenin 14(1.8) të Ligjit Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, NJIF-K do t'i bëjë publike raportet (përfshirë raportin e të dhënave statistikore) që do të ndihmojnë në kryerjen e detyrave të saj.

REZULTATET KRYESORE TË PUNËS SË NJIF-K 2022

Inteligjenca Financiare



Në vitin 2022, 173 raporte të inteligjencës u referuan agjencive të zbatimit të ligjit për hetime të mëtutjeshme. Vlera e transaksioneve fondeve të ngrira nga NJIF-K në vitin 2022 ka vazhduar duke arritur të identifikoj transaksione të dyshimta dhe t'i ngrijë rreth 5.1 milion euro.

Koordinimi Kombëtar



Janë zhvilluar një sërë aktiviteteve përmes mekanizmave të partneritetit publik-publik dhe publiko-privat.

Mbikqyrja e Pajtushmërisë



Intensifikimi i mbikëqyrjes së bazuar në risk ka vazhduar duke ndërmarrë 27 inspekte të pajtushmërisë. Janë forcuar kapacitetet përmes mentorimit të mbikëqyrjes së bazuar në risk.

Fuqizimi i vlerësimit të rrezikut, menaxhimit të rrezikut dhe kornizës strategjike



Është bërë përmirësimi i të kuptuarit të riskut të pastrimit të parave/Financimit të terrorizmit në Kosovë përmes adresimit të gjeturave të NRA dhe zhvillimi i masave për zbutjen e

rrezikut. Janë inicuar tri vlerësime të rrezikut sektorial.

Përforsimi i partneritetit publiko privat



Përmirësimi dhe zhvillimi i partneritetit publik-privat është përforsuar përmes trajnimeve, punëtorive, e cila ka ndikuar në rritjen e fluksit të informacionit ndërmjet sektorit financiar dhe NJIF-it për t'i ofruar zbatuesve të ligjit inteligjencën e nevojshme për të zbuluar dhe parandaluar pastrimin e parave dhe veprat e ndërlidhura.

Zhvillimet Ligjore



Roli aktiv i NJIF-K në forcimin e legjislacionit kombëtar, ka rezultuar me miratimin e akteve legjislative në përputhje me standardet e caktuara të FATF dhe kërkesat e Direktivës së BE-së 2018/843. Miratimi i Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve Financiare Ndërkombëtare të Shënjestruara. Është iniciuar hartimi i legjislacionit për ndërtimin e regjistrin nacional të pronësisë përfituese. Ligji për PPP/LFT është në proces të plotësim-ndryshimit.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar




Në vitin 2022, NJIF-K shkëmbeu me partnerët ndërkombëtar 121 informacione të inteligjencës financiare. NJIF-K pranor certifikatë mirënjohjeje për kontributet e çmuara të NJIF Kosovë të dhënë në Egmont Group

ANALIZA DHE MONITORIMI

Të dhënat dhe raportet e proceduara


Në vitin 2022, NJIF-K regjistroi gjithsej 11,293 raporte të cilat janë proceduar në sistemin elektronik të përpunimit të të dhënave.




Grafiku 1: Numri i raporteve të proceduara përmes sistemit elektronik dhe online 2022

Raportet e Transaksioneve/Aktiviteteve të Dyshimta (RTD/RAD)

NjIF-K ka pranuar 960 RTD/RAD në vitin 2022 ose mesatarisht 80 RTD/RAD në muaj. Kjo pasqyron një ngritje të raportimit prej 4 % krahasuar me 920 RTD/RAD të raportuara në vitin 2021.



Grafiku 2: Numri i RTD-ve të raportuara në dy vitet e fundit 2021 dhe 2022



Grafiku 3: Numri i RTD-ve të raportuara 2018-2022


Bankat përbëjnë numrin më të lartë të RTD-ve (65%) në krahasim me sektorët tjerë. Ndërsa Institucionet tjera Financiare dhe IFJB-të përbëjnë 31% të numrit të gjithmbarshëm të RTD-ve. Nga sektori i Institucioneve tjera Financiare, Agjencionet për Transfer Parash përbajnë numrin më të lartë të raportimeve të RTD-ve, dhe krahasuar me vitin paraprak, numri i raportimeve të dyshimta është ngritur nga këto agjencione për 42%. Nga Institucionet Financiare jo Bankare (IFJB-të), është shënuar ngritje e theksuar e raportimeve nga Institucionet Financiare të autorizuara për lëshimin dhe menaxhimin e mënyrave të pagesës (paratë elektronike), si dhe nga Fondet Pensionale.

Sektori i Bizneseve dhe Profesioneve të Caktuara jo Financiare (BPCJF-të) përbën 4% të numrit gjithsej të raportimit të RTD-ve. Krahasuar me vitin paraprak, ka një ngritje prej 6% të raportimit edhe nga ky sektor. Kryesisht ngritja është shënuar tek Noterët dhe tek Personat fizikë dhe juridikë që tregojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë.

Treguesit kyç të Performancës, tregojnë që nga gjithsej RTD/RAD e pranuar në vitin 2022 (960 gjithsej), 98% e tyre janë trajtuar thuajse gjitha brenda këtij viti, krahasuar me 81% në vitin 2021. Kjo pasqyron një ngritje prej 17% të trajtimit të RTD/RAD-ve me vitin paraprak, gjë që reflekton ngrije të efektivitetit në trajtimin e raporteve të dyshimta të pranuar gjatë vitit 2022. Përderisa vetëm 2% e RTD/RAD-ve të pranuar në vitin 2022 janë bartur për t'u trajtuar në vitin pasues 2023.

Treguesi Kyç i Performancës	Gjithsej RTD 2022	%
Numri i raporteve të marra mbi transaksionet e dyshimta PP (RTD)	836	87%
Numri i raporteve të marra mbi aktivitetet e dyshimta PP (RAD)	118	12%
Numri i raporteve të marra mbi dyshimin e financimit të terrorizmit TFR	6	1%
Gjithsej RTD/RAD/TRF të pranura 2022	960	100.00%
Rezultatet e analizave të RTD/RAD/TRF-ve		
Procesimi i STR-ve/SAR/TFR për t'u analizuar (open CAP&CAS)	741	77%
STR/SAR/TFR bashkangjitur rasteve ne proces	177	18%
Arkivim i STR/SAR/TFR	22	2%
Gjithsej RTD/RAD/TRF të trajtuar (analiza paraprake) 2022	940	98%
STR/SAR/TFR ne shqyrtim (posedim te analistave, te pa trajtuar)	20	2%
Gjithsej	960	100.00%

Tabela 1: Treguesit kyç të përformancës në trajtimin e RTD/RAD/TFR 2022



Grafiku 4: Raporti i trajtimit të RTD-ve 2022


Të dhënat tregojnë që 77% e raporteve të dyshimta janë procesuar për analizim më të thellë bazuar në analizën e riskut. Përderisa 18% janë bashkangjitur rasteve në proces, ndërsa vetëm 2% janë arkivuar për shkak të dyshimit shumë të ulët.

Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2018-2022					
Subjektet Raportuese	2018	2019	2020	2021	2022
Bankat dhe Institucionet Financiare					
Bankat	559	785	710	661	620
Institucionet Mikrofinanciare	10	17	13	27	12
Sektori i sigurimeve	2	5	1	1	-
Këmbimoret (Këmbimi i parave dhe monedhave)	-	-	-	-	-
Agjensionet për Transfer Parash	33	137	149	182	259
Leasing	-	3	5	6	5
Institucionet tjera Financiare (IFJB)	-	-	-	-	21
BPCJF-të					
Agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme	-	-	-	-	-
Avokatët	2	1	1	2	1
Noterët	37	76	17	34	35
Kontabilistët e çertifikuar dhe këshilltarët tatimor	-	1	-	-	-
Auditorët e licencuar	-	-	-	-	-
Trustet dhe ofruesit e shërbimeve për kompanitë	-	-	-	-	-
Organizatrat Jo-Qeveritare	-	-	-	-	-
Shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar	-	-	-	-	-
Personat fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë	-	-	3	0	2
Profesionistë të tjerë	-	-	-	-	-
Mbikqyrësit dhe institucionet tjera					
Dogana e Kosoves	1	-	1	-	-
Mbikqyrësit sektorial	-	1	-	2	-
Tjera	-	1	2	5	5
Gjithsej RTD-të e raportuar 2018-2022	644	1027	902	920	960

Tabela 2: Numri i RTD-ve të raportuara sipas sektorëve 2018-2022

Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)

NjIF-K ka pranuar 2,848 raporte në para të gatshme me gjithsej 1,006,729 transaksione (RTG) në 2022 ose mesatarisht rreth 83,894 RTG në muaj. Kjo është një ngritje prej 4% krahasuar me 971,300 RTG të raportuara në NJIF-K në vitin 2021.



Grafiku 5: Numri i RTG-ve të pranuar 2018-2022

Ka passur ngritje të raportimit të RTG-ve nga tregtarët me vlera të larta si tregtarët apo shitësit e makinave, posaçërisht të makinave të shtrenjta/luksoze. Gjatë vitit 2022, Auto-Sallonet kanë raportuar rreth 130 raporte të transaksioneve në para të gatshme, që shënon progresin më të lartë të raportimeve të tilla në 10 vitet e fundit.

Raportimi i Deklarimit Kufitar (BCR)

Në vitin 2022, NJIF-K ka pranuar 1,768 BCR. Krahasuar me vitin paraprak 2021, numri i raportimeve ka qenë i përafërt.

Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare			
Numri i Raporteve të deklaruara			
Vitet	Personat Juridik	Personat Fizik	Numri i deklarimit te RTG-ve
1	2	3	4 = (2+3)
2022	1,240	528	1,768
2021	1,388	388	1,776
2020	554	232	786
2019	650	319	969
2018	816	396	1,212
2017	664	444	1,108
2016	732	424	1,156
2015	606	658	1,264
2014	667	583	1,250
Gjithsej	7,317	3,972	11,289

Tabela 3: Deklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2014-2022

Sipas paragrafit 7 të nenit 33 të Ligjit për PPP/LFT-në, DK-ja ka fuqinë të konfiskoje instrumentet monetare në kufi që dyshohet se janë të ardhura nga krimi. Kjo duhet t'i njoftohet menjëherë Prokurorit për hetim. DK-ja gjithashtu duhet të informojë NjIF-in. Gjithashtu ndaj personit i cili nuk respekton dispozitat e deklaramit sipas ligjit, kryen veprë të kundërvajtjes që dënohet me gjobë prej njëzet e pesë përqind (25 %) të shumës totale të instrumenteve monetare në posedim për të cilat ka detyrim për të deklaruar.

Statistikat në vijim janë paraqitur në lidhje me mos-deklaratat fizike ndërkufitare:

Mosdeklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare				
Vitet	Numri i mosdeklari meve	Vlera e mosdeklarimit të mjeteve	Valuta	Gjoba e shqiptuar (25%)
2019	3	91,080.00	GBP	18,000.00 EURO
		33,200.00	EURO	91,080.00 GBP te konfiskuara ne total
		790	CHF	7.681.00 EURO
2020	1	65,450.00	EURO	16,362.50 EURO
2021	6	100,977.12	CHF	26,677.56 EURO
		70,509.82	EURO	17,627.46 EURO
		16,510.00	GBP	4,140 EURO
2022	13	325,580.00	EURO	81,400.00
Gjithsej	23	107,590.00	GBP	91,080.00 GBP te konfiskuara
		101,767.12	CHF	90,488.52 EURO
		169,159.82	EURO	

Tabela 4: Mosdeklarimi i mjeteve monetare në pikat kufitare 2019-2022

Analiza Operative dhe Strategjike

NjIF-K ka mandat ligjor të kryejë:

(a) analizë operative dhe

(b) analizë strategjike.

Në vitin 2022, janë hapur gjithsej 1,078 raste për analizim, apo 6% më tepër krahasuar me vitin paraprak 2021.

Rastet e hapura për analizim 2018-2022					
Rastet e Hapura	2018	2019	2020	2021	2022
Rastet e hapura (CAS) bazuar në RTD	68	64	261	195	260
Propozim rastet (CAP) e hapura bazuar ne RTD	505	474	868	582	542
Rastet e hapura (CAS) nga NJIF-K (që i janë ofruar vullnetarisht NjIF-K-së)	4	6	8	8	1
Rastet e hapura (CAS) nga Informatat Spontane nga FIU tjera	5	6	11	17	2
Kërkesat për shkëmbim të informacionit (RFI)	159	167	173	200	220
Rastet e hapura (CAS) nga BCR për mos-deklarim të mjeteve në pikat kufitare	-	-	-	-	3
Projektet e përbashkëta te analizave operative nga analiza strategjike dhe/ose hetimeve me Institucionet tjera te zbatimit te ligjit	6	5	3	12	50
Gjithsej rastet e hapura për analizim	747	722	1324	1014	1078

Tabela 5: Rastet e hapura 2018-2022

Ngritjen më e madhe numrit të rasteve të hapura për analizim në vitin 2022, ka ardhur si rezultat i Projekteve të përbashkëta te analizave operative nga analiza strategjike dhe/ose hetimeve me Institucionet tjera te zbatimit te ligjit. Bashkëpunimi më i theksuar ka qenë i orientuar në luftimin e ekonomisë jo-formale dhe shmangies nga tatimi, i cilia ka rezultuar me 56% të hasteve të hapuara¹ në bashkëpunim të ngushtë me ATK. Përderisa 24% e Projekteve të hapura kanë qenë me Policinë e Kosovës, dhe 14% me Prokurorinë dhe 6% të tjera.

Projektet e përbashkëta te analizave	Nr.Projektet e përbashkëta	%
ATK	28	56%
PK	12	24%
Prokuroria	7	14%
Tjera	3	6%
Gjithsej rastet e hapura për analizim	50	100.00%

Tabela 6: Rastet e hapura - Projektet e përbashkëta te analizave operative nga analiza strategjike dhe/ose hetimeve me Institucionet tjera te zbatimit te ligjit, viti2022


¹ bazuar në Projektet e Përbashkëta të analizës strategjike dhe operative

Analizat strategjike kanë qenë me prioritet edhe në vitin 2022, kryesisht në formën e përcjelljes së trendeve të PP/FT, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e të kuptuarit të rreziqeve. Në vitin 2022, NJIF-K ka hapur për analizim 7 analiza strategjike me qëllim të prodhimit të tre produkteve kyçe të Analizës Strategjike;

- Produktet përshkruese
- Raportet e Tipologjive
- Raportet e trendëve

Analizat Strategjike të hapura për analizim 2018-2022					
Rastet e hapura	2018	2019	2020	2021	2022
Produktet përshkruese	-	-	-	2	2
Raportet e Tipologjive	-	-	-	2	1
Raportet e trendëve	1	2	3	5	4
Gjithsej	1	2	3	9	7

Tabela 7: Analiza Strategjike të hapura 2018-2022




Grafiku 6: Analiza Strategjike të hapura 2018-2022

Kosova është vlerësuar lartë në nivel ndërkombëtar në përpjekjet e saj për ndjekjen penale të pastrimit të parave, duke e vendosur një rast të sukseshëm të Kosovës në rastet më të mira të Egmont Group për vitet 2014-2020 ².

CASE

5

Unprecedented Global Multibillion Cryptocurrency Euro Fraud (Kosovo, FIU-Kosovo)




² https://egmontgroup.org/wp-content/uploads/2022/01/2021-Financial.Analysis.Cases_.2014-2020-3.pdf

SHPALOSJA, SHPËRNDARJA DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek autoritetet e zbatimit të ligjit

Në vitin 2022, NJIF-K ka shpërndarë për hetime të mëtutjeshme tek agjencionet e zbatimit të ligjit gjithsej 173 raporte të inteligjencës.



Grafiku 7: Raportet e shpërndara të inteligjencës 2015-2022

Në tabelën më poshtë janë paraqitur të dhënat e raporteve të shpërndara nga NJIF-K në pesë vitet e fundit (periudha 2018-2022):

Raportet e shpërndara të inteligjencës 2018-2022					
Referuar në institucione përkatëse	2018	2019	2020	2021	2022
Policia e Kosovës	59	74	73	84	65
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	8	5	19	12	5
Administrata Tatimore e Kosovës	33	52	46	76	83
Dogana e Kosovës	2	0	2	4	3
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	3	4	7	8	2
Agjencia Kundër Korrupsionit	2	1	0	0	0
EULEX	1	0	0	0	0
Fiu ndërkombëtare/Informacion Spontan	13	15	12	16	12
Tjera	2	2	3	4	3
Gjithsej	123	153	162	204	173

Tabela 8: Raportet e inteligjencës të shpërndara/referuara në institucione përkatëse 2018-2022


Ndihma hetimore e ofruar për agjencitë e zbatimit të ligjit

Gjatë vitit 2022, NJIF-K ka pranuar 240 kërkesa për shkëmbim të informacionit, 37% më tepër se vitin paraprak (200 kërkesa në vitin 2021). Si gjithëherë, numri më i lartë i kërkesave edhe gjatë vitit 2022 ka rrjedhur nga Policia e Kosovës (53% e gjithsej kërkesave të pranuar). Numri i kërkesave për shkëmbim të informatave është rritur ndjeshëm nga AKI gjatë vitit 2022. Kjo ka ardhur si rezultat i fuqizimit të bashkëpunimit mes NJIF-K dhe AKI dhe nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit për zyrtarët ndërlidhës. Kurse pjesa tjetër e kërkesave pasohet nga Dogana, Prokuroria e Shtetit, ILECU, BQK etj, si në vijim:

Institucionet parashtruese të kërkesës	Nr.kërkesave
Policia e Kosoves	145
AKI	73
Prokuroria e Shtetit & PSRK	13
ATK	2
Dogana e Kosoves	13
ILECUs	14
BQK	6
Tjera	8
Gjithsej	274

Tabela 9: Shkëmbimi i informacionit - vendor 2022


Në të shumtën e rasteve, kërkesat për shkëmbim të informacionit (IRD) ndërlidhen me një hetim të filluar nga një shpërndarje e inteligjencës së NJIF-K të rrjedhur nga RTD-të që u shpërnda për hetime të mëtutjeshme në një agjenci të zbatimit të ligjit.



Grafiku 8: Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF 2016-2022

Shkëmbimi i informacionit dhe mbështetja për mbikëqyrësit e pajtueshmërisë


Gjatë vitit 2021, BQK ka parashtruar 6 kërkesa për shkëmbim të informacionit me NJIF-K:



Grafiku 9: Shkëmbimi i informacionit me mbikëqyrësit e pajtueshmërisë 2016-2022

NGRIRJA E TRANSAKSIONEVE BANKARE

Numri i udhëzimeve të lëshuara nga NJIF-K në vitin 2022 për pezullim të transaksioneve ose ngrirjen e përkohshme të transaksioneve, ka qenë gjithsej 30 urdhra ngrirje, në vlerë totale të transaksioneve të pezulluara/ngrira prej **5,015,244 Euro**, që tregon për performancën më të mirë të treguar nga NJIF-K.




Grafiku 10: Vlera e transaksioneve/fondeve të ngrira nga NJIF-K 2016-2022

Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit							
Urdhrat për ngrirje	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i udhëzimeve të lëshuara për pezullim të transaksionit	85	3	4	3	31	46	30
Shuma (EUR)	1,036,146	1,007,933	250,852	151,060	1,093,643	8,975,202	5,015,244

Tabela 10: Ngrirja e Llogarisë/Transaksionit 2016-2022


MBIKËQYRJA E BAZUAR NË RREZIK

Gjatë vitit 2022, plani vjetor i inspektimeve është realizuar kryesisht duke u përqendruar në inspektimet me fushëveprim të kufizuar dhe inspektime pasuese.



Grafiku 11: Inspektimi i Pajtueshmërisë sipas llojit 2022

Në vitet e fundit një fokus i theksuar i mbikqyrjes është përqendruar në sektorët e identifikuar me rrezik si Noterët, Bankat, Institucionet Mikrofinanciare, zyret e këmbimit valutor etj.



Grafiku 12: Inspektimi i Pajtueshmërisë në vend dhe nga distanca 2014 - 2022

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për inspektimet në vend dhe në distancë në vitet 2018-2020.

Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2018-2022										
Subjektet raportuese të inspektuara	2018		2019		2020		2021		2022	
	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
Banka	-	-	1	2	1		2			
Institucione Mikrofinanciare	3	-	1	-	-	-	1			
Kompani të Sigurimit dhe Sigurimit të Jetës	-	1	2	1						
Zyrat e Këmbimit Valutor	-	-	-	-	-	-	2		7	
Agjensione për transferime të parave	-	-	1	-	1	-				
Kazino dhe Lojra të Fatit	4	-	-	-	-	-				
OJQ	-	-	-	-	-	-				
Auditor & Kontabilistë	-	-	-	-	-	19	2			
Noterët	6	-	-	17	-	-		24	1	19
Agjensione për patundshmëri	-	-	-	-	-	-				
Auto Sallone					10	-				
Inspektimet në vend dhe distancë	13	1	5	20	12	19	7	24	8	19
Gjithsej Inspektimet e Pajtueshmerise	14		25		31		31		27	

Tabela 11: Inspektimi i Pajtueshmërisë në vend dhe nga distanca 2018-2022

Ndëshkimet Administrative

Gjatë vitit 2022, NJIF-K me qëllim të zbutjes së rrezikut dhe ndërmarrjes së masave përmirësuese ka lëshuar një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve për masat përmirësuese që duhet të ndërmerren nga subjektet raportuese, si dhe janë vendosur masa administrative.

Gjithsej 131 rekomandime për masat përmirësuese janë dhënë për subjektet e inspektuara, përdërisa është shqiptuar 1 ndëshkim administrativ në vlerë monetare prej gjithsej 50,000 Euro.

Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim 2022			
Subjektet raportuese	Rekomandimet për masat përmirësuese	Numri i Ndëshkimeve administrative	Vlera monetare e gjobave të shqiptuara (Euro)
Banka	-	-	-
Institucione Mikrofinanciare	-	-	-
Zyrat e Këmbimit Valutor	16	1	50,000.00
Auditor & Kontabilistë	-	-	-
Noterët	115	-	-
Gjithsej	131	1	50,000

Tabela 12: Ndëshkimet administrative dhe masat për përmirësim 2022

Vetëdijesimi, trajnimi dhe komunikimi për PPP/LFT dhe përforcimi i partneritetit publiko-privat dhe publiko-publik

NjIF-K ndërvepron në sferën vendore dhe ndërkombëtare me partnerë publikë dhe privatë, qëllimi i përbashkët i të cilëve është luftimi dhe parandalimi i pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit. Për këtë qëllim, me ndihmën e projektit PECK III u organizua edhe një punëtori dy ditore më 20 dhe 21 tetor 2022 në Prishtinë me qëllim të ngritjes së vetëdijes për partneritetin publik-privat dhe publik-publik për të diskutuar edhe modalitetet e mëtutjeshme të bashkëpunimit.

Me datë 22 dhe 23 shkurt 2022 është mbajtur takimi mes ekspertësh për mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të Kosovës në mbikëqyrjen e fushës kundër pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit (LPP/LFT). Qëllimi i takimeve, ishte diskutimi i strukturës aktuale dhe përcaktimi i mbikëqyrjes së ardhshme të LPP/LFT, kuadri i bashkëpunimit ndërmjet Njësisë së Inteligjencës Financiare (NjIF) dhe mbikëqyrësve potencialë sektorialë për disa kategori subjektesh të detyruara. Përfaqësuesit e NjIF-it, Bankës Qendrore, Ministrisë së Drejtësisë dhe Odës së Noterëve diskutuan modalitetet e bashkëpunimit bazuar në nevojat dhe kapacitetet e tyre dhe ndanë informacion praktik mbi kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi, si dhe mbi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin dhe përmirësimin e Mbikëqyrja e LPP/LFT. Informacioni i mbledhur do të shërbejë si bazë për përgatitjen e një udhërrëfyese gjithëpërfshirës për mbikëqyrjen e përbashkët dhe të qëndrueshme të LPP/LFT me rekomandime konkrete për modalitetet e bashkëpunimit.

Më 17 dhe 18 mars 2022 është organizuar një trajnim dyditor për përfaqësuesit e OJQ-ve mbi rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PP/FT). Ngjarja u zhvillua dhe mbledhi së bashku përfaqësues të 14 OJF-ve të ndryshme dhe NjIF. Trajnimi kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit si dhe rritjen e njohurive praktike të përfituesve mbi pastrimin e parave dhe financimin e rreziqeve dhe dobësive të terrorizmit të OJQ-ve dhe masat e mëvonshme zbutëse.



Burimi: PECK III

Në datat 21-22 prill 2022 është organizuar trajnim me temë "Transparenca e pronësisë përfituese si një mekanizëm efektiv për të luftuar keqpërdorimin e personave juridikë për qëllime të paligjshme" i cili u zhvillua në kuadër të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Projekti kundër krimit ekonomik në Kosovë (PECK III). Trajnimi kishte për qëllim forcimin e aftësive të institucioneve financiare dhe mbikëqyrëse në lidhje me regjimin e pronësisë përfituese (OB) dhe rritjen e njohurive të tyre praktike mbi

identifikimin e Pronarëve Përfitues Përfundimtar të personave juridikë dhe marrëveshjeve ligjore. Trajnimi u realizua për 38 përfaqësues të Njesisë së Inteligjencës Financiare, Bankës Qendrore të Kosovës dhe bankave komerciale. Gjithashtu, morën pjesë përfaqësues të Bankës Qendrore të Malit të Zi dhe subjektet raportuese të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, të cilët ndanë njohuritë dhe përvojat e tyre praktike.

Në datat 20-23 qershor 2022, mbi 70 avokatë, noterë, kontabilistë, auditorë dhe agjentë të makinave me qira morën pjesë në "Trajnimin për Bizneset dhe Profesionet e Përcaktuara Jo-Financiare. Qëllimi i këtij trajnimi ishte promovimi i një kuptimi më të mirë të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga subjektet raportuese dhe zbatimi i një qasjeje të bazuar në rrezik ndaj detyrimeve të tyre LPP/LFT.

Në Shtator 2022, NJIF-K ka mbështetur Shoqatën e Bankave të Kosovës në organizimin e konferencës rajonale LPP/LFT 2022. Pjesëmarrësit në konferencë ishin përfaqësues të bankave vendore në Kosovë, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Njesisë së Inteligjencës Financiare të Republikës së Kosovës si dhe përfaqësues të organeve rregullatore, si dhe institucionet, shoqatat bankare dhe agjencitë e inteligjencës financiare nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Sllovenia dhe Turqia.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë tema të tilla si qasja e bazuar në rrezik për LPP/LFT nga këndvështrimi i Rregullatorit, si të hartohet një Program efektiv i Pajtueshmërisë së LPP/LFT në Banka si dhe efektiviteti në Kontrolllet e Zbulimit të Sistemit të Pajtueshmërisë LPP/LFT.

Edhe gjatë vitit janë mbajtur takimet periodike mes NJIF-K, BQK dhe Shoqates se Bankave.

ZBATIMI I SANSKIONEVE NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2022, NJIF-K ka lëshuar 31 urdhra të monitorimit të llogarive apo marrëdhënies së biznesit, të cilat konsistojnë në:


Viti 2022	
Urdhrat e monitorimit të lëshuar nga NJIF-K	Nr. i urdhrave të lëshuar
Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare (Zbatimi i Vendimeve të Qeverisë)	24
Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare (OFAC lista, etj)	6
Parandalimi dhe luftimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	1
Gjithsej	31

Tabela 13: Urdhrat e monitorimit të lëshuar nga NJIF-K 2022

Gjatë vitit 2022, NJIF-K me qëllim të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare (Zbatimi i Vendimeve të Qeverisë), Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare (OFAC lista, etj) dhe për qëllime të parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka lëshuar gjithsej 31 Urdhrat e monitorimit/ngrirjes ndaj 1,811 personave/entiteteve të përcaktuara:

Viti 2022	
Numri i personave/entiteteve të përcaktuara ndaj të cilëve janë lëshuar urdhrat e monitorimit/ngrirjes	Numri
Numri i personave të përcaktuar	1479
Numri i entiteteve të përcaktuara	332
Gjithsej	1811

Tabela 14: Numri i personave/entiteteve të përcaktuara ndaj të cilëve janë lëshuar urdhrat e monitorimit/ngrirjes 2022



Grafiku 13: Personat/entitetet e përcaktuara ndaj të cilëve janë lëshuar urdhrat e monitorimit/ngrirjes 2022

TIPOLOGJITË E PP/FT

Tregtarët me vlera të larta

Tregtarët me vlera të larta përcaktohen si tregtarë që tregtojnë

- a) metale dhe gurë të çmuar (MGÇ); dhe
- b) vetura, kryesisht të shtrenjta/luksi.

Ekzistojnë disa qindra tregtarë të MGÇ-ve të vendosura anembanë Kosovës që shkojnë nga tregtarët e mëdhenj tek të vegjël dhe që janë mjaft të qasshëm për klientët vendas.

Tregtarët me vlera të larta që bëjnë tregti në mallra me pagesa në para të gatshme prej 10,000 eurosh ose më shumë në një transaksion të vetëm ose në një seri transaksionesh të lidhura ose transaksionesh dukshëm të lidhura, duhet të zbatojnë masat e KDK-së për transaksione të tilla, të mbajnë shënime adekuate për transaksionet, dhe TMGÇ-të përcaktohen në mënyrë specifike si subjekte raportuese që duhet të raportojnë transaksione të dyshimta, nëse zbulohen.

Ky sektor supozon rrisje të pastrimit të parave pasi tregtia e tij ka natyrë globale. Kjo sugjeron që gjurmimi i palëve në transaksione është sfidues, duke krijuar vështirësi shtesë për agjencitë e zbatimit të ligjit të interesuara për kryerjen e hetimeve.

Tregtia e metaleve të çmuar dhe auto-sallonet, duke qenë se këto zakonisht shkëmbehen për para të gatshme, mund të supozojë një sfidë edhe më të lartë për agjencitë qeveritare

Sinjale alarmi për PPP

Sinjali më i madh i alarmit është mospërputhja e çmimeve. Kriminelët mund të jenë të interesuar të pastrojnë fitime të paligjshme përmes tregtisë së këtyre aseteve, pasi vlera e tyre është e lartë dhe ato ofrojnë nivele të larta të anonimitetit. Sa më e lartë të jetë vlera që kriminelët u caktojnë këtyre aseteve, aq më shpejt ata do të jenë në gjendje t'i pastrojnë paratë kriminale.

Përndryshe, njerëzit mund të jenë të interesuar të raportojnë një pjesë të pagesës tek autoritetet lokale me qëllim shmangien e tatimeve. Në këtë rast, kriminelët nuk do ta përdorin këtë sektor për të vendosur fitime të paligjshme, por ata do të krijojnë fitime të paligjshme përmes evazionit tatimor, të cilat më pas do të duhet të pastrohen.

Tipologjitë e mëposhtme ilustrojnë disa nga risqet e pastrimit të parave në Kosovë në sektorin e tregtarëve me vlera të larta.

Shërbimet bankare korrespondente

FATF i përcakton shërbimet bankare korrespondente si ofrimin e shërbimeve bankare nga një bankë ("banka korrespondente") për një bankë tjetër ("banka respondente"). Bankave respondente mund t'u sigurohet një gamë e gjerë produktesh dhe shërbimesh nga banka korrespondente, megjithëse ky term nuk vlen për transaksione që bëhen vetëm një herë, pasi lidhet me transaksione të vazhdueshme ndërmjet institucioneve.

Standardet Ndërkombëtare nuk kërkojnë nga institucionet që të kryejnë NJKT për klientët e klientëve të tyre (NJKKT). Sidoqoftë, institucionet duhet të vendosin procedura për të zbuluar dhe reaguar ndaj ndryshimeve në profilin e riskut të institucionit respondent.

Kur zbulohen shqetësime, institucioni korrespondent duhet t'i përcjellë me institucionin respondent duke bërë një kërkesë për informacion

(KPI) për çdo transaksion të veçantë. Pas marrjes së informacionit, institucioni korrespondent duhet të vlerësojë nëse institucioni respondent mbetet brenda oreksit për risk. Nuk pritët të realizohet asnjë NJKKT në emër të institucionit korrespondent.

Për shkak të riskut të lartë për PP që përfaqësojnë shërbimet bankare korrespondente, institucionet bankare të Kosovës duhet të kenë vendosur procedura efektive të NJKT-së për t'i zbuluar institucionet të cilave bankat kosovare u ofrojnë shërbime bankare korrespondente. KDK-ja dhe shpeshësia e rishikimit duhet të përshtaten me riskun e klientit.

Sistemi financiar i Kosovës është i ndërtuar mbi 10 banka. Bankat përfaqësojnë një risk shumë të lartë të pastrimit të parave, dhe shërbimet bankare korrespondente janë një aktivitet që përfaqëson një risk të lartë brenda sistemit bankar. FATF ka nxjerrë një Udhëzim për shërbimet bankare korrespondente në tetor 2016 (vegza).

Për më tepër, Wolfsberg Group, një asociacion i trembëdhjetë bankave globale që synon të adresojë risqet e krimit financiar, ka publikuar materiale për të mbështetur zbatimin e Kujdesit të Duhur për Shërbimet Bankare Korrespondente, përfshirë një pyetësor për PPP (vegza). Bankat e Kosovës mund t'i konsiderojnë këto materiale gjatë miratimit dhe rishikimit të procedurave për PPP.

Produkte dhe shërbime komplekse

Në këtë abstrakt duhet të konsiderohen edhe metodat e reja të pagesës dhe monedhat virtuale. Asetet virtuale kanë krijuar një ekosistem të prirur për të rritur anonimitetin, ndërsa platformat dhe shkëmbyesit janë bërë gjithnjë e më të decentralizuar, duke mundësuar uljen e transparencës dhe rritjen e maskimit të flukseve financiare, si dhe shfaqjen e modeleve të tjera të biznesit të aseteve virtuale, si ofertat e monedhave,

që përfaqësojnë risqe për PP/TF, përfshirë risqe të mashtrimit dhe manipulimit të tregut.

Për më tepër, vazhdojnë të shfaqen tipologji të reja të financimit të paligjshëm, duke përfshirë përdorimin në rritje të skemave të shtresimit virtual-virtual. FATF ka publikuar një Udhëzim mbi Asetet Virtuale dhe Ofruesit e Shërbimeve të Aseteve Virtuale.

KDK - Pronësia përfituese

Pronësia përfituese i referohet personit (personave) fizik që në fund të fundit posedon ose kontrollon një klient dhe/ose personin fizik në emër të të cilit po kryhet një transaksion. Kjo përfshin edhe ata persona që ushtrojnë kontroll përfundimtar efektiv mbi një person ose aranzhim juridik.

Instrumentet e korporatave - siç janë kompanitë, fondet e mirëbesimit, fondacionet, partneritetet dhe llojet e tjera të personave dhe aranzhimeve juridike - kryejnë një larmi aktivitesh tregtare dhe ndërmarrëse. Sidoqoftë, përkundër rolit thelbësor dhe legjitim që luajnë instrumentet e korporatave në ekonominë globale, në kushte të caktuara, ato janë keqpërdorur për qëllime të paligjshme, përfshirë pastrimin e parave (PP), ryshfetin dhe korrupsionin, ujdite e brendshme, mashtrimin tatimor, financimin e terrorizmit (FT), dhe aktivitete të tjera të paligjshme. Kjo ndodh sepse për kriminelët që përpiqen të anashkalojnë masat për parandalimin e pastrimit të parave (PPP) dhe kundër financimit të terrorizmit (KFT), instrumentet e korporatave janë një mënyrë tërheqëse për të maskuar dhe konvertuar fitimet e krimit, përpara se t'i fusin në sistemin financiar.

Keqpërdorimi i instrumenteve të korporatave mund të zvogëlohet ndjeshëm nëse informacioni në lidhje me pronarin e ligjshëm dhe pronarin përfitues, burimin e aseteve të instrumentit të korporatës dhe aktivitetet e tij do të ishin të disponueshme për autoritetet. FATF ka publikuar


një Udhëzim për Transparencën dhe Pronësinë Përfituese për t'u ndihmuar juridiksioneve dhe subjekteve raportuese në këtë temë (vegza).

Subjektet raportuese duhet të ndajnë burime shtesë për të identifikuar pronësinë përfituese të instrumenteve të mëposhtme, të cilat mund të errësojnë informacionin e pronësisë:

- Kompanitë guacë (kompani të regjistruara që nuk kanë veprimtari të rëndësishme ose asete të lidhura);
- Strukturat komplekse të pronësisë dhe kontrollit përfshijnë shumë shtresa të aksioneve të regjistruara në emër të personave të tjerë juridikë;
- Aksionet e bartësve dhe urdhrat e aksioneve të bartësve;
- Përdorimi i pakufizuar i personave juridikë si drejtorë;
- Aksionarët dhe drejtorët me nominim (in)formal;
- Fondet e mirëbesimit dhe aranzhimet e tjera juridike mundësojnë ndarjen e pronësisë të ligjshme dhe pronësisë përfituese të aseteve;
- Përdorimi i ndërmjetësve në formimin e personave juridikë, përfshirë ndërmjetësit profesionistë.

Juridiksionet kanë pranuar sfida të ndryshme në identifikimin e pronësisë përfituese të personave juridikë. FATF ka publikuar një punim mbi praktikën më të mirë për këtë çështje, një plotësim i Udhëzimit për fshehjen e pronësisë përfituese.

Tipologjia I - Tregtarët me vlera të larta




Subjekti A, i interesuar për të shitur një subjekt biznesi në Kosovë, dhe subjekti B, i interesuar për ta blerë, kryejnë transaksionin përmes një firme juridike. Sipas burimit të fondeve të subjektit B, të ardhurat vjetore nga aktiviteti i vet i biznesit nuk kanë asnjë lidhje logjike, e shumën që posedon për blerjen e subjektit të biznesit.

Fondet për blerjen janë me origjinë të dyshimtë.

TREGUES TË RISKUT TË LARTË

- ✓ Subjekti i biznesit me çmim të gabuar - çmimi zyrtar i transaksionit të subjektit të biznesit është dukshëm më i ulët/më i lartë se çmimi i tregut. Nëse është dukshëm më i ulët, palët në transaksion mund të jenë të interesuara për uljen e pagesave tatimore; nëse është dukshëm më i lartë, palët mund të jenë të interesuara të simulojnë shpenzime më të larta për të kërkuar lehtësime tatimore

Tipologjia II - Shërbimet bankare




Llogaria e subjektit A nuk kreditohet nga veprimtaria e biznesit e subjektit të regjistruar kohët e fundit, por nga transferet ndërkombëtare, përmes një ndërmjetësi të vendosur në Kosovë, nga një subjekt i vendosur në një juridiksion me risk më të lartë. Në këtë rast, ndërmjetësi mban një marrëdhënie bankare korrespondente me bankën e subjektit A.

Këto fonde transferohen më pas në një llogari të huaj bankare private nën emrin e subjektit A, ose tërhiqen

TREGUES TË RISKUT TË LARTË


- ✓ Ndërmjetësimi - ndërmjetësit zakonisht përdoren për të siguruar shtresim shtesë në operacionet e kryera nga kriminelët. Për më tepër, kjo i distancojnë shumë kriminelët nga fondet në transaksion, gjë që në fund të fundit vështirëson gjurmueshmërinë e fondeve.
- ✓ Juridiksione me risk më të lartë - transaksioni ndërkufitar mund të përfaqësojë një tregues të riskut të lartë pasi komplikon gjurmueshmërinë e fondeve. Nëse juridiksionet e përfshira janë me risk më të lartë, do të thotë se ato konsiderohen nga FATF si vende që nuk mund t'i trajtojnë në mënyrë efektive risqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, atëherë kjo do të supozonte një risk shtesë. Institucionet duhet të jenë shumë vigjilente ndaj palëve të vendosura në këto juridiksione.
- ✓ Llogaritë private - për shkak të nivelit më të ulët të transparencës së këtyre produkteve, këto llogari ulin gjurmueshmërinë e fondeve

Mbajtja e aksioneve apo të drejtave të votës në mënyrë indirekte – zinxhirët e pronësisë



Në skemën e mësimërme, K Co është kompani kosovare në të cilën 30% e aksioneve mbahen nga F Co (kompani e huaj) dhe A mban pjesën tjetër prej 70%. Prandaj, A ka zotërim të drejtpërdrejtë prej më shumë se 25% dhe është pronar përfitues i K Co. B mban 80% të aksioneve në F Co kështu që ka aksione indirekte në K Co që arrijnë në 24% në total (d.m.th. 80% nga 30%). Kjo do të thotë se B nuk ka zotërim të përgjithshëm në G Co prej më shumë se 25% sipas testit të kuantifikimit, por mban një pjesë të shumicës në një subjekt i cili zotëron më shumë se 25% të të drejtave të votës në G Co. Prandaj, B është një pronar përfitues i G Co. C dhe D secili mbajnë 10% të aksioneve në F Co kështu që secili ka aksione indirekte në G Co prej 3% në total (d.m.th. 10% nga 30%). Pasi që as nuk kanë zotërim të përgjithshëm në K Co prej më shumë se 25% sipas provës sasiore, e as shumicë të aksioneve në një subjekt që mban më shumë se 25% të të drejtave të votës në K Co, ata nuk janë pronarë përfitues të K Co.

Mbajtja e aksioneve apo të drejtave drejtpërdrejt




Në figurën 1, K Co është një kompani kosovare në të cilën A mban 60% të aksioneve, B mban 10% të aksioneve dhe C dhe D së bashku kanë 30% të aksioneve. Ndërsa A mban më shumë se 25% të aksioneve në K Co, A është pronar përfitues i K Co. B mban më pak se 25% të aksioneve në K Co, kështu që B nuk është pronar përfitues i K Co. C dhe D së bashku mbajnë më shumë se 25% të aksioneve në K Co, dhe si aksione të mbajtura bashkërisht duhet të trajtohen se u përkasin në tërësi, secilit person që i mban ato, C dhe D janë pronarët përfitues të K Co.

BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI VENDOR

Për shkak të natyrës unike të rolit të NJIF-K dhe të dhënave të tij, ajo pranon në mënyrë rutinore kërkesa për shkëmbim të informatave (IRD) nga agjencitë partnere vendase për të mbështetur operacionet e tyre. Numri i kërkesave të bëra në NJIF-K në 2022 është ngritur për 37% krahasuar me vitin paraprak, (274 kërkesa këtë vit krahasuar me 200 të pranuar vitin paraprak).

Numri më i lartë i kërkesave përgjatë vitit 2022 ka rrjedhur nga Policia e Kosovës (145 kërkesa), i përcjellë nga AKI (73 kërkesë), Prokuroria e Shtetit & PSRK (13 kërkesa), Dogana (13 kërkesa) . Për llogari të autoriteteve të tjera (ATK, ILECU, AKK, BQK) janë trajtuar 30 kërkesa për shkëmbim të informacionit.



Grafiku 14: Kërkesat për informata (IRD) të parashtruar nga institucionet bashkëpunuese të NJIF-K

NJIF-K është e autorizuar të përpilojë informata, statistika, raporte dhe, duke u bazuar në ato, t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit. Nisur nga kjo, gjatë vitit 2022 NJIF-K ka përcjell tek autoritet tjera katër (4) rekomandime si në vijim:


- ◇ AKI - Raporti i Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë/Rekomandim;
- ◇ BQK - Komentet lidhur me Rregulloren për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit/Rekomandim;
- ◇ DOJQ/MPB - Rekomandim në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit;
- ◇ Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti Komentet lidhur me draft projektligjin për krypto-asetet.

NJIF-K dhe AZL janë pjesë e grupit për zbulimin dhe shënjestrimin e krimit të rëndë që udhëhiqet nga PSRK dhe që vepron në pajtim me Procedurat Standarde të Operimit për Përzgjedhjen dhe Shënjestrimin e rasteve të Krimeve të Rënda dhe Ekipeve Hetimore Ndër-Agjenci. Si rezultat, përfaqësuesi i NJIF-K gjatë vitit 2022 ka marrë pjesë në takimet e rregullta të Ekipit të Përbashkët për Përzgjedhjen dhe Shenjëstrimin e Krimeve të Rënda.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve

Gjatë vitit 2022 janë shkëmbyer rreth 121 informata me homologët e huaj.




Grafiku 15: Shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit 2015-2022

Shumica e kërkesave (rreth 59%) për shkëmbim ndërkombëtar të informacionit midis NjIF-eve ishin kërkesa nga vendet e Bashkimit Europian. Përderisa rreth 27% ishin nga vendet e rajonit të vendeve të Ballkanit Përendimor. Ndërkohë që 21% ishte nga vendet e tjera jashtë kontinentit. Ky trend i shkëmbimit të informacionit është edhe në përputhje me profilin e rrezikut.


Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2017-2022						
VITET	2017	2018	2019	2020	2021	2022
KËRKESAT E PRANUARA						
Kërkesat e huaja të pranuar nga NjIF-K	33	32	26	32	43	37
Kërkesat e huaja të refuzuara nga NjIF-K	0	0	0	0	0	0
Ndarja spontane e informacionit të marrë nga NjIF-K	7	12	19	28	21	12
GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i pranuar)	40	44	45	60	64	49
KËRKESAT E DËRGUARA						
Kërkesat e dërguara nga NjIF-K	37	62	74	42	55	61
Ndarja spontane e informacionit të dërguar nga NjIF-ët	5	13	15	13	18	11
GJITHSEJ (kërkesat dhe informacioni i dërguar)	42	75	89	55	73	72

Tabela 15: Shkëmbimi ndërkombëtar i informatave 2017-2022

Gjatë vitit 2022, NJIF-K ka dërguar 61 kërkesa në 29 NjIF të huaja, dhe pranoi 37 kërkesa nga 16 NjIF të huaja. Përderisa janë ndarë 11 informacione spontante me 6 NJIF të huaj dhe pranoi 12 informacione spontante nga 6 NJIF të huaj.



Grafiku 16: Kërkesat e huaja të pranuar dhe dërguara nga NJIF-K 2017-2022




Grafiku 17: Ndarja spontane e informacionit 2017-2022

Shkëmbimi më i lartë i informacionit gjatë kësaj periudhe është bërë me FIU nga Shqipëria (15%), e ndjekur nga FIU Gjermani (11%), FIU Itali (7%), FIU Maqedoni e Veriut dhe FIU Zvicër (6%) etj.

Juridiksioni	Nr. i këreksave/informacionit spontan të shkëmbyer	%
ALBANIA	18	15%
GERMANY	13	11%
ITALY	8	7%
NORTH MACEDONIA	7	6%
SWITZERLAND	7	6%
MONTENEGRO	5	4%
AUSTRIA	4	3%
NETHERLANDS	4	3%
UKRAINE	4	3%
UNITED KINGDOM	4	3%
HUNGARY	3	2%
ROMANIA	3	2%
SLOVENIA	3	2%
SWEDEN	3	2%
BOSNIA AND HERZEGOVINA	2	2%
BULGARIA	2	2%
CYPRUS	2	2%
GREECE	2	2%
LITHUANIA	2	2%
MALTA	2	2%
POLAND	2	2%
UNITED ARAB EMIRATES	2	2%
UNITED STATES	2	2%
Others	17	14%
Total	121	100%


Tabela 16: Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve sipas juridiksioneve për vitin 2022



Memorandumi i Mirëkuptimit

MoU të nënshkruara nga NJIF-K me homologët e huaj		
	Juridiksioni	Viti
	Shqipëria (DPPPP)	2009
	"Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë" (MLPD)	2009
	Mali i Zi (APML)	2009
	San Marino (FIA)	2009
	Slovenia (OMLP)	2009
	Kroacia (AMLO)	2010
	Turqia (MASAK)	2012
	Republika Çeke (FAU-CR)	2012
	Finlanda (FIU)	2013
	Polonia (GIIF)	2014
	Shqipëria (DPPPP) - ripërtëritje	2014
	Hungaria (HFIU)	2015
	Maqedonia (FIO) - ripërtëritje	2015
	Ghana (FIC)	2015
	Lituania (FNNT)	2016
	Jordania (AMLU)	2018
	Senegal (CENTIF)	2018
	Mali i Zi (FIU)	2019
	Taiwan (AMLDD)	2020
	Arabia Saudite (SAFIU)	2022
	Japan (JAFIC)	2022

Tabela 17: MoU të nënshkruara nga NJIF-K me homologët e huaj



BUXHETI DHE PROKURIMI


Për vitin 2022, Ligji Nr. 08/L- 066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës ka përcaktuar shumat e lejuara për shpenzim dhe ka venë në dispozicion për shpenzim nga fondi i Kosovës për NjIF-K shumën prej 475,316 Euro.

Sipas klasifikimit ekonomik, ndarjet buxhetore për vitin 2022, janë paraqitur si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Gjithsej
246,370	187,471	11,475	30,000	475,316

Tabela 18: ndarjet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik për vitin 2022

Ndër vite, ndarja e shpenzimeve sipas nënkategorive ekonomike ishte realizuar si në vijim:



Grafiku 18: Ndarja e shpenzimeve sipas nënkategorive ekonomike 2018-2022

Sipas klasifikimit ekonomik, për financimin e aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2022, NjIF-K ka shpenzuar 403,793 € apo 84.95% të buxhetit të aprovuar.

Ne tabelën në vijim paraqiten linjat buxhetore dhe realizimi i tyre për vitin 2022. Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, e shprehur në përqindje, është e paraqitur në tabelën më poshtë.

Kategoritë Ekonomike	Buxheti aprovuar për vitin 2022	Buxheti i shpenzuar	Realizimi %
	ndarja fillestare	realizimi	
	1	2	3
Paga dhe mëditje	246,370	205,060	83%
Mallra dhe shërbime	187,471	161,801	86%
Shpenzimet komunale	11,475	7,143	62%
Shpenzime kapitale	30,000	29,789	99%
Gjithsej	475,316	403,793	85%

Tabela 19: Tabela e ndarjeve dhe realizimit të buxhetit 2022

Prokurimi Publik

Gjatë vitit 2022, janë ndërmarrë veprimet e mëposhteme në zyrën e prokurimit në NJIF-K:


- ✓ Është hartuar dhe implementuar Plani dhe Strategjia e Prokurimit për NJIF-K, duke bërë sigurimin se të gjitha kërkesave për prokurim për mallra, shërbime, punë apo shërbime të konsulencës të jenë të nënshkruara nga personat e autorizuar dhe të jenë në harmoni me procedurat e prokurimit.
- ✓ Është bërë organizimi, planifikimi, mbikëqyrja dhe zbatimi efikas dhe efektiv i furnizimit me mallra, shërbime dhe punë sipas kërkesave të cilat paraqiten në NJIF-K
- ✓ Është ndihmuar MFPT në përgatitjen e dokumentacionit te nevojshëm për tenderë si dhe kontratat për mallra dhe shërbime
- ✓ Është bërë koordinimi i punëve brenda institucioni dhe me institucionet publike që mbikëqyrin Prokurimin Publik në Kosovë si dhe subjektet e tjera të kësaj fushe.

Gjatë vitit 2022 sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 janë zhvilluar gjithsej dhjetë (7) aktivitete të prokurimit.

Sipas procedurës aktivitetet e prokurimit janë të ndara në :

- Një (1) aktivitete të prokurimit me procedurë të hapur,
- Shtate (7) aktivitete kanë qenë me procedurën e kuotimit.
- Një (1) aktivitete kanë qenë me procedurën e vlerës minimale.
Ndërsa sipas vlerës se planifikuar të prokurimit
- Një (1) janë me vlerë të mesme.
- Shtate (7) janë me vlerë të vogël dhe.
- Një (1) janë me vlerë minimale.


Gjate vitit 2022 janë kryer edhe këto aktivitete nga Agjencia Qendror e Prokurimit (AQP):
Furnizim me Goma, Furnizim me letër për kopje, Furnizim me Ujë, Furnizim me karburante për nxhemje dhe Gjenerator për nevojat të NJIF-it, Furnizim me karburante për vetura për nevojat të NJIF-it dhe Shërbime të Transportit Ajror.



Burimet njerëzore & ngritja e kapaciteteve të NJIF-K

Bazuar në LIGJI NR. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2022, NJIF-K ka të aprovuara 24 pozita. Gjatë vitit 2022, dy punonjës të njësisë kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre, ndërsa aktualisht, të punësuar me orar të plotë janë 18 (tetëmbëdhjetë) gjithsej.

Gjithashtu, gjatë këtij viti NJIF-K ka investuar në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit për të ngritur nivelin e performancës së tyre dhe efikasitetin në punë. Planifikimi për ngritjen e kapaciteteve për NJIF-K për 2022 është bërë duke u bazuar në nevojat e identifikuar të stafit dhe specifikave të pozitave të tyre në fund të vitit 2021 dhe fillim të vitit 2022. Trajnimet janë mbajtur brenda dhe jashtë Kosovës dhe kanë përfshirë të gjithë sektorët e njësisë. Ngritja e kapaciteteve ka ndikuar pozitivisht në ngritjen e efikasitetit të punës brenda njësisë.



LISTA E SHKURTESAVE

NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
LFT	Luftim i Financimit të Terrorizmit
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia kundër Korrupsionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BPCJF	Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë
FATF/TFVF	Task Forca e Veprimit Financiar
FT	Financimi i Terrorizmit
goAML	Sistemi elektronik i menaxhimit të dhënave
ILECU	Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit
OJQ	Organizatë joqeveritare
PK	Policia e Kosovës
PP	Pastrimi i parave
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
RTD/STR	Raporti i Transaksionit të Dyshimtë
RTG/CTR	Raporti i transaksionit në të gatshme (kesh)
TFR	Raportet e transaksioneve të dyshimta për financim të terrorizmit
AIF	Raportet e informative shitesë
FRZ	Raportet për pezullimin e transaksioneve
INR	Raportet e Inspektimit të Pajtushmërisë
IRD	Kërkesat vendore për Informata të pranuar
IRI	Kërkesat ndërkombëtare për informata të pranuar
ORD	Kërkesat e NjIF-K për autoritetet vendore
ORI	Kërkesat e NjIF-K drejtuar NjIF-ve ndërkombëtare
UTR	Raportet e transaksioneve të pazakonshme

